



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TË UJRAVE

Plani i Integruar i Ministrisë 2008

Shkurt 2008

Mesazhi i Ministrit

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujerave, në kuadër të zbatimit të objektivave të qeverisë për vitin 2008 dhe në mbështetje të masave të tjera të planifikuara synon që nëpërmjet këtij programi të integruar t'i përmbushë ato dheveçanërisht objektivat që lidhen me përmirësimin e cilësisë së mjedisit, mbrojtjes dhe administrimit të pyjeve dhe burimeve ujore. Ministria synon gjithashtu të përmirësojë politikat në fushën e peshkimit si dhe të forcojë masat e kontrollit në qëllim mbrojtje dhe administrimin e qëndrueshëm të rezervave peshkore në vendin tonë.



Realizimi i objektivave të mësipërme bëhet i mundur nëpërmjet një planifikimi dhe përdorimi efektiv të fondeve buxhetore të cilat synojnë në përmirësimin e infrastrukturës, rritjen e kapaciteteve planifikuese dhe manaxhuese si dhe në rritjen e investimeve që kanë për qëllim rehabilitimin e sipërfaqeve të dëmtuara dhe të degraduara si dhe të rritjes së sipërfaqeve me mbjellje të reja në pyje.

Lufter Xhuveli

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Lufter Xhuveli', written in a cursive style.

Ministër i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave

Pasqyra e lëndës

1	Misioni i Ministrisë	4
2	Dokumenta strategjike të Ministrisë	5
3	Programet buxhetore të Ministrisë	6
4	Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2008.....	7
5	Plani i Monitorimit i Ministrisë	11
Aneks 1	Projekt-ligjet për t' paraqitur	12
Aneks 2	Rezultate që lidhen me Integrimin European	14
Aneks 3	Investimet publike	16
Aneks 4	Projekte të ndihmës së huaj	17

1 Misioni i Ministrisë

Harton dhe zbaton politika, strategji, programe dhe projekte të cilat synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mjedisit, përbërësve të tij dhe administrimin e qëndrueshëm të burimeve ujore dhe rezervave peshkore, duke synuar ruajtjen dhe konsolidimin e mëtejshëm të këtyre rezervave; zhvillimin e sektorit të pyjeve dhe kullotave nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të politikave dhe masave mbështetëse me qëllim mbrojtjen e pyjeve nga dëmtimet e mëtejshme si dhe rehabilitimin e sipërfaqeve të dëmtuara dhe të degraduara; përafrimin e legjislacionit të fushës së mjedisit dhe të standarteve mjedisore në përputhje me direktivat e Bashkimit European.

Politikat e ministrisë janë të orientuara drejt zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit dhe burimeve natyrore si pyjet, ujërat, peshkimi duke synuar në rritjen e nivelit ekonomik dhe të cilësisë së jetës së brezave të sotëm dhe atyre që do të vijnë.

2 Dokumenta strategjike të Ministrisë

Strategjia sektoriale e mjedisit

Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2007-2013 është dokumenti bazë që parashtron politikën shtetërore në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Qëllimi përfundimtar i zbatimit të saj është plotësimi i detyrimit kushtetues ndaj shtetasve që gëzojnë të drejtën e një mjedisi të shëndetshëm dhe ekologjik, zhvillimit të Shqipërisë në mënyrë të qëndrueshme nëpërmjet përdorimit racional të pasurive natyrore, ruajtjes së tyre nga ndotja dhe degradimi si dhe promovimit të vlerave mjedisore për t'i kthyer ato në asete të rëndësishme të rritjes së mëtejshme ekonomike të vendit. Kjo strategji tashmë është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe është në zbatim.

Qëllimet

Politika e këtij sektori është orientuar dhe hartuar për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata:

- Hartimi dhe sigurimi i zbatueshmërisë të gjithë disiplinave ligjore në mbrojtje të mjedisit për të arritur tregues të lartë të rivendosjes së tyre me efekte të prekshme në cilësinë e mjedisit. Monitorimi i të gjithë treguesve mjedisorë dhe adoptimi i standarteve të monitorimit mjedisor me ato të KE-së; trajtimi me përparësi i të gjitha "vatrave të nxehta mjedisore", me nivel të lartë ndotjeje, të trashëguar nga industrinë e amortizuara, apo të krijuara rishtazi; rritja e sipërfaqeve të gjelbërta dhe informimi i publikut mbi gjendjen reale të mjedisit.
- Menaxhimi i kujdesshëm i burimeve ujore dhe ekonomikisht të vlefshme edhe nga ana sociale dhe mjedisore. Kjo do të arrihet nëpërmjet krijimit të një sistemi bashkëmenaxhimi të përshtatshëm dhe një sistemi të besueshëm të grumbullimit të të dhënave për përmirësimin e licensimit dhe përafrimit të legjislacionit. Objektivi afatgjatë është krijimi i një sistemi bashkëmenaxhimi të qëndrueshëm ekonomikisht dhe ekologjik në favor të komuniteteve lokale dhe qendrore.
- Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve ujore dhe përmirësimi i cilësisë së burimeve ujore; Forcimi i kontrollit të shfrytëzimit të inerteve lumore me tendencë ndalimin e tyre; Forcimi i strukturave lokale në nivel të baseneve ujore me qëllim mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të rezervave ujore; Forcimi i bashkëpunimit me vendet kufitare për të koordinuar masat e përdorimit dhe shfrytëzimit të rezervave ujore ndërkufitare.
- Shtimi i sipërfaqeve të reja pyjore, rehabilitimi i sipërfaqeve të djegura dhe të degraduara, shtimi dhe mirëmbajtja e veprave ujëmbajtëse në kullota, kontrolli i fenomeneve të erozionit nëpërmjet ndërtimit të veprave hidroteknike, përmirësimi të menaxhimit të produkteve pyjore dhe jopyjore, i cili do të çojë në gjenerimin e të ardhurave. Politikat e ndërmarra në sektorin pyjor do të ndikojnë në përmirësimin e situatës aktuale të pyjeve dhe kullotave, rritjen e numrit të aktiviteteve që do të ndikojnë në përmirësimin e kushteve social-ekonomike në zonat rurale.

3 Programet buxhetore të Ministrisë

3.1 PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e kushteve të punës, përmirësimin e direktivave menaxhuese dhe zhvillimin institucional. Zhvillimin e politikave dhe të strategjive të sektorëve mjedisor. Rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve natyrore. Rritjen e kapaciteteve menaxhuese për zhvillimin, përgatitjen dhe zbatimin e politikave, hartimin dhe zbatimin e ligjeve në përputhje me standartet e BE-së.

3.2 PROGRAME PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Politika e këtij programi konsiston në administrimin e mjedisit dhe mbrojtjen e tij, nëpërmjet hartimit të politikave dhe zbatimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e mjedisit, monitorimin e treguesve mjedisorë, kontrollin për zbatimin e kushteve të lejeve mjedisore, vlerësimin e ndikimit në mjedis për të gjitha aktivitetet që e dëmtojnë atë, bashkëpunimin me organet e pushtetit vendor për administrimin dhe mbrojtjen e tij nga ndotja dhe dëmtimi, rehabilitimin e pikave të nxehta mjedisore. Mbrojtja e biodiversitetit (florës dhe faunës) si dhe mbrojtja e tokës nga erozioni dhe ndotja janë gjithashtu komponentë të rëndësishëm për mbrojtjen e mjedisit.

3.3 MBËSHTETJE PËR PESHKIM

Politika e këtij programi mbështetet në menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve të gjalla ujore duke respektuar ekosistemin dhe biodiversitetin, peshkimin e përgjegjshëm, me qëllim që të përbëjë një burim ushqimi, aktiviteti pune, tregëtie, argëtimi dhe mirëqenieje për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm.

3.4 ADMINISTRIMI I UJRAVE

Politika e këtij programi konsiston në administrimin e burimeve ujore për të plotësuar nevojat e popullsisë, bujqësisë dhe prodhimin e energjisë elektrike; kufizimin e veprimtarive që shkaktojnë dëmtim të ekosistemeve ujore dhe veçanërisht të lumenjve ku shfrytëzimi pa kriter i inerteve ka sjellë dalje të lumenjve nga shtretërit e tyre e devijime të rrjedhjes; bashkëpunimin në nivel ndërkufitar për administrimin e rezervave ujore që shtrihen në kufijtë midis vendeve.

3.5 ADMINISTRIMI I PYJEVE

Politika e këtij programi konsiston në zhvillimin e qëndrueshëm dhe shumëfunksional të resurseve pyjore dhe kullosore, që sigurojnë dhe mbrojnë biodiversitetin, prodhimtarinë, aftësinë ripërtëritëse, vitalitetin dhe potencialin e tyre për të përmbushur funksionet ekologjike, ekonomike dhe sociale në nivel lokal, kombëtar dhe global e pa shkaktuar dëme në ekosisteme të tjera.

4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2008

Sipas programeve, Ministria do të ofrojë produktet e mëposhtme në 2008.

4.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Objektivat e politikës

Përmirësimi i sistemit të informacionit për burimet njerëzore sipas kategorive, rretheve, nivelit arsimor për çdo punonjës.

Përmirësimi i përdorimit të fondeve buxhetore në 10 institucione të vartësisë nëpërmjet auditimit.

Përfundimi i të gjithë amendimeve dhe bazës ligjore në përputhje me matricen dhe planin e përafrimit të legjislacionit me atë të BE-së.

Produktet kryesore që synohet të ofrohen

Realizimi i 12 auditimeve financiare në institucionet vartëse.

Monitorimi, zbatimi i politikave të ministrisë dhe nxerrja e 3 akteve ligjore.

Staf i trajnuar në masën 10% nëpërmjet seminareve të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

Blerje pajisjesh (kompjuterat, printera, fax, tavolina, karike, rafte).

4.2 PROGRAME PER MBROJTJEN E MJEDISIT

Objektivat e politikës

Hartimi dhe zbatimi i të gjitha disiplinave ligjore në mbrojtje të mjedisit dhe përafrimit me acquis;

Menaxhimi i procesit të monitorimit të mjedisit dhe informimi i publikut mbi rezultatet;

Mbrojtja dhe shtimi i biodiversitetit, zonave dhe specieve të mbrojtura;

Mbështetje ndaj iniciativave për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe përdorimit të burimeve energjitime të rinovueshme;

Zbatimi i projekteve të reja në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe rehabilitimit të pikave të nxehta mjedisore;

Mbështetje e iniciativave për mbrojtjen e shtresës së Ozonit;

Produktet kryesore që synohet të ofrohen

- Hartimi i akteve ligjore të reja dhe zbatimi i atyre ekzistuese në fushën mjedisit, përmirësimi i procedurave të licensimit dhe mirëfunksionimi i inspektoriatit të mjedisit në bashkëpunim me strukturat lokale.
- Rritja e frekuencës së matjes së treguesve të mjedisit 3% në shkallë vendi.
- Inventari i të gjithë aktiviteteve dhe paisjeve që përdorin lëndë ozon holluese (LHO).
- Asistencë teknike në fushën e rikuperimit dhe riciklimit të Lëndëve Ozon Holluese.
- Menaxhimi i integruar i liqenit ndërkufitar të Prespës.
- Eleminimi i ndotjes në pikat e nxehta mjedisore.
- Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në Korçë.

- Identifikimi i 5 pikave të reja të nxehta mjedisore .
- Ngritja e sistemit të monitorimit të ndryshimeve klimatike dhe impaktit të tyre në ekosistemin e lumenjve Drin-Mat si dhe masat adaptuese.
- Ngritja e kapaciteteve në sektorin publik dhe privat për të mundësuar financimet e karbonit në Shqipëri.
- Manuali për doganierët në zbatim të VKM-së 453, datë 23/06/2005.

4.3 MBESHTETJE PER PESHKIM

Objektivat e politikës

- Ristrukturimi dhe zgjerimi i infrastrukturës portuale dhe qendrave të peshkimit nëpërmjet një porti të ri.
- Mbrojtja dhe menaxhimi i rezervave peshkore nëpërmjet kontrolleve mbi subjektet e licensuara dhe programeve të ripopullimit.
- Plotësimi dhe përafrimi i legjislacionit të peshkimit me përkthimin dhe përshtatjen e rregulloreve.
- Menaxhimi i infrastrukturës së peshkimit (për të gjitha portet dhe qendrat e peshkimit).

Produktet kryesore që synohet të ofrohen

- Kryerja e kontrolleve nga NRZPM Sarandë në portet e peshkimit dhe OMP për zbatimin e kërkesave të ligjit për peshkimin .
- Përfundimi i projektit të zbatimit për portin e peshkimit Durrës.
- Prodhimi i rasate të koranit (1 milion), të krapit (500 mijë cope) dhe rasate të blera (500 mijë copë).
- Ushtrimi i 800 kontrolleve në të gjithë kategoritë ujore.
- Hartimi i rregulloreve të reja të peshkimit (tre rregullore).

4.4 ADMINISTRIMI I UJRAVE

Objektivat e politikës

Forcimi organizativ dhe i kontrollit i Agjensive të Ujit për zbatimin e legjislacionit në fushën e përdorimit të rezervave ujore dhe shfrytëzimit të inerteve.

Produktet kryesore që synohet të ofrohen

Licencimi i 7 subjekteve për kontrollin e baseneve të lumejve të vendit për një shfrytëzim sipas normave ligjore të tyre.

Monitorimi i subjekteve të licensuara në basenet e 6 lumejve të vendit.

4.5 ADMINISTRIMI I PYJEVE

Objektivat e politikës

Organizimi i një kadastrë moderne për ruajtjen e tërësisë së fondit pyjor e kullosor

Rehabilitimi i pyjeve dhe kullosave të degraduara për t'i kthyer në kushtet optimale të stacionit pyjor e kullosor

Menaxhimi i qendrueshëm i burimeve pyjore dhe kullosore

Produktet kryesore që synohet të ofrohen

Mbajtja e kadastrave pyjore dhe kullosore e informatizuar në 12 qendra rajonale.

Rritja e sipërfaqeve të pyllëzuara prej 4%.

Mbështetja e me asistencë teknike për planet e menaxhimit të 30 pyjeve komunale.

Tabela Buxheti 2008 sipas programeve dhe llojeve të shpenzimeve, million Lek

Programet	Pagat dhe kontribute sigurimeve shoqërore 600, 601	dhe e Mallra dhe shërbime 602	Subveconet 603	Të tjera transferta korrente 604, 605	Transferta buxhetet familiare individët 606	për Shpenzim dhe e kapitale 230, 231	Total
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	54	15	0	5	0	5	79
Programe për mbrojtjen e mjedisit	56	11	0	21	0	248	336
Mbështetje për peshkimin	38	25	0	0	40	291	394
Administrimi i ujrave	18	3	0	0	0	0	21
Administrimi i pyjeve	623	170	0	15	0	364	1,172
Total	789	224	0	41	40	908	2,002

5 Plani i Monitorimit i Ministrisë

Identifikoni dhjetë produktet/treguesit më të rëndësishëm që do të monitorojnë arritjet e ministrisë gjatë vitit 2008.

Treguesit	Njësia	Qëllimi
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		
Realizimi i auditimeve financiare në institucionet vartëse.	nr	12
Programe për mbrojtjen e mjedisit		
Hartimi i akteve ligjore të reja dhe plotesimi i atyre ekzistuese në fushën mjedisit	nr	21
Rritja e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura	ha	40 mijë
Identifikimi i pikave të reja të nxehta mjedisore.	nr	5
Manuali për doganieret në zbatim të VKM-së 453, datë 23/06/2005.	nr	1
Mbështetje për peshkim		
Ushtrimi i kontrolleve në për zbatimin e ligjit të peshkimit	Nr.	800
Prodhimi i rasateve të koranit dhe Krapit	cope	1.5 milion),
Administrimi i ujrave		
Licencimi i subjekteve për kontrollin e baseneve të lumejve të vendit për një shfrytëzim sipas normave ligjore të tyre.	nr	25
Monitorimi i subjekteve të licensuara në basenet e 6 lumejve të vendit.	nr	periodik
Administrimi i pyjeve		
Mbështetja e me asistence teknike për planet e manaxhimit të pyjeve komunale.	nr	30

Aneks 1 Projekt-ligjet për t'u paraqitur

- Projektligji “Per mbrojtjen e menaxhimin e faunës së egër”
- Projektligji “Për rezervat ujore”
- Projektligji “Për Aderimin në Protokollin e Konventës së vitit 1979 “Mbi ndotjen atmosferike ndërkufitare në distanca të mëdha, lidhur me kontrollin e shkarkimeve të oksideve të Azotit ose rrymave të tyre ndërkufitare”
- Projektligji “Për amendimin e kreut IV të Kodit Penal “Për krimet në mjedis”
- Projektligji “Për Aderimin në Protokollin e Konventes së vitit 1979 “Mbi ndotjen atmosferike ndërkufitare në distanca të mëdha, lidhur me pakësimin e shkarkimeve të squfurit ose të rrymave të tyre ndërkufitare, të paktën 30%”
- Projektligji “Përgjegjësia mjedisore për parandalimin e dëmit në mjedis dhe rehabilitimi sipas parimit “ndotësi paguan”
- Projektvendim “Për kërkesat e kushtet e pajisjes me lejë të trajtimit e shfrytëzimit të pyjeve”
- Projektvendim “Kriteret dhe mënyra e caktimit të vlereës së dëmit të shkaktuar në pyje e kullota”
- Projektvendim “Për procedurat e pjesmarrjes së publikut në vendimmarrje”
- Projektvendim “Për shpalljen Park Kombëtar Rajcë Shebenik”
- Projektvendim “Për procedurat e heqjes shtimit dhe ndryshimeve të zërave kadastral në fondin pyjor e kullosor”
- Projektvendim “Për rregullat dhe procedurat që zbatohen për projektet a veprimtaritë që zhvillohen në territorin e RSH me ndikime të mundshme negative në mjediset apo ujrat ndërkufitare”
- Projektvendim “Për përbërjen dhe organizimin e Komiteti teknik të zhurmave (KTZH)
- Projektvendim për kriteret, procedurat dhe rregullat për certifikimin, pezullimin dhe heqjen e çertifikatës së ekspertit të zhurmës në mjedis
- Projektvendim për shpalljen Zonë e Mbrojtur “Zgjerimi i Siperfaqes së Parkut Kombëtar ‘Bredhi i Hotovës-Dangelli’”
- Projektvendim “Për kriteret për ndarjen e shkeljeve me pasoja të lehta apo të rënda në pyje dhe kullota”
- Projektvendim “Për ngritjen e rrjetit të inventarizimit dhe monitorimit të biodiversitetit”
- Projektvendim “Për llojet e huaja të florës dhe faunës”
- Udhëzim i Ministrit “Për mbajtjen e kadastrës kombëtare të fondit pyjor dhe kullosor”
- Udhëzim i Ministrit “Për formatimin e dokumentacionit që do të përdoret në komunikimet me palën shkaktare nga ndikimet mjedisore ndërkufitare”
- Udhëzim i Ministrit “Për listen Tip të shpenzimeve për procedurat ndërkufitare dhe kriteret metodike për përlllogaritjen e tyre”
- Udhëzim i Ministrit për Procedurat e tërheqjes së publikut në procesin e VNM

- Udhëzim i përbashket i ministrit të mjedisit, ministrit të shëndetsise dhe ministrit përkatës për miratimin e nivelit kufi të zhurmës nga burimet e lëvizshme dhe paisjet e vendosura në mjedisin e jashtëm.
- Udhëzim i ministrit të mjedisit “ Për miratimin e metodës së llogaritjes së indikatorëve të zhurmave”

Aneks 2 Rezultate që lidhen me Integrimin European

Forcimi i kapacitetesh në DPPN për ajrin.

Forcimi i kapacitetesh për drejtorinë e DPPN për mbetjet.

Forcimi i kapaciteteve në AUB.

Zbatim i ligjit të amenduar për rezervat ujore-ndërgjegjësimi i publikut me anë të seminareve.

Ngritja dhe funksionimi i Komiteteve të Menaxhimit të PK Llogara dhe RNM Kune-Vain.

Vazhdimi i projektit të eliminimit të stokut të arsenikut në Fier.

Vazhdimi i projektit të rafinerisë së Ballshit.

Funksionimi i zyrës së regjistrimit të kimikateve.

Trajnime të autoriteteve doganore.

Monitorimi i cilësisë së ajrit nga institucionet vendase.

Projekt vendim “Për rregullat dhe procedurat për projektet dhe veprimtari me ndikim ndërkufitar ku Shqipëria është palë shkaktare”.

Projekt udhëzim “Për formatin e dokumentacionit për komunikimet me palën shkaktare të ndikimeve ndërkufitare”.

Projekt udhëzimit “Për listen tip të shpenzimeve për procedurat ndërkufitare dhe kriteret metodike për përllogaritjen e shpenzimeve të tyre”.

Miratimi i vendimeve të Keshillit Kombëtar të Ujërave.

Projekt VKM “Për shpalljen e PK Rajcë -Shebenik”.

Projekt ligji “Për mbrojtjen dhe menaxhimin e faunës së egër”.

Zbatimi i rregullave dhe procedurave për projektet dhe veprimtaritë me ndikim ndërkufitar ku Shqipëria është palë shkaktare, dhe listës së llogaritjes së shpenzimeve në këto raste.

Projekt VKM “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit për paketimin dhe paketimin e mbeturinave”.

Projektakt për kompostimin e mbetjeve.

Projektakt për landfillimin e mbetjeve dhe incinerimin.

Amendim i ligjeve ekzistuese lidhur me menaxhimin e resurseve ujore dhe parandalimin e ndotjes së ujërave.

Projekt VKM “Për shpalljen e zonave të mbrojtura: zgjerimi i Parkut të Llogorasë”.

Fillimi i zbatimit të projektit CARDS 2006 “Transportimi i mbetjeve të rrezikshme nga hot spotet mjedisore në landfillin e mbetjeve të rrezikshme”.

Fillimi i zbatimit të projektit për hartimin e planit të menaxhimit të mbetjeve urbane dhe të rrezikshme.

Aktivitetet në kuadër të binjakezimit me SIDA/SEPA për monitorimin e ujit.

Investime për paisje për monitorimin e ujit.

Shtimi i stafit në DPPN për ujë.

Forcimi i kapacitetesh në drejtorinë e DPPN për zhurmat.

Përcaktimi i autoriteteve kompetente për zhurmat nga automjetet.

Trajnime të stafit dhe aktorëve të tjerë për regjistrin kombëtar.

Aneks 3 Investimet publike

Emërtimi i projektit të investimit	Projektbuxheti 2008
Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave	313,977
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	5,000
Orendi dhe pajisje	2,000
Rikonstruksion	3,000
Administrimi i Pyjeve	169,977
Pyllëim	35,895
Pyllëzim (nga të ardhurat)	38,700
Zëvëdësim	1,300
Shërbime kulturore	2,600
Përmirësim pyjor	18,200
Mirëmbajtje rrugësh	1,950
Mirëmbajtje lerash	13,715
Fidanishte pyjore (nga të ardhurat)	1,300
Sistemime malore	12,212
Sistemime malore (nga të ardhurat)	10,000
Zonat e mbrojtura	14,105
Kosto lokale - Projekti i Zhvillimit të Burimeve Natyrore	10,000
TVSH - Projekti i Zhvillimit të Burimeve Natyrore	10,000
Programe për Mbrojtjen e Mjedisit	30,000
TVSH	10,000
Kosto lokale	20,000
Mbështetje për Peshkimin	109,000
Thellimi i kanalit të komunikimit të lagunes së Butrintit me detin	30,000
Kosto lokale - Projekti për Portin e ri të Peshkimit në Durrës	55,000
TVSH - Projekti për Portin e ri të Peshkimit në Durrës	24,000

Aneks 4 Projekte të ndihmës së huaj

Emri i projektit	Donatori	Kosto totale (mije lekë lekë)	Data e mbarimit
Programe për mbrojtjen e mjedisit			
“Mundësimi i Shqipërisë për të përgatitur komunikimin e dytë kombëtar në përgjigje të Konventes Kuadër për Ndryshimet Klimatike	GEF/UNDP	11,326	2008
Projekti: PDF B: “Transformimi i tregut për përdorimin e paneleve diellore për ujë të ngrohtë në Shqipëri”:	GEF/UNDP	62,500	2012
Projekti: Mundësimi i Shqipërisë për të pranuar financime të karbonit	Qeveria Austriake/UNDP	20,000	2008
Projekti: PDF B “Identifikimi dhe zbatimi i masave për adaptimin në deltën e lumenjve Drin - Mat”.	GEF/UNDP	26,450	2011
Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në Korçë	SIDA	10,000	2008
Përgatitja e projektit “Për ruajtjen dhe menaxhimin e qendrueshëm të Liqenit të Prespës”	GEF/UNDP	41,200	2010
Projekti i Ozonit: Forcimi i Institucional	UNEP/UNDP	2,000	2010
Projekti i Ozonit. Heqja nga përdorimi i LHO-ve	UNIDO	10,000	2008
Projekti i Ozonit. Monitorimi dhe kontrolli	UNIDO	2,000	2010
Projekti ”Forcimi i kapaciteteve për vendet e Ballkanit perëndimor për trajtimin e pikave të nxehta mjedisore sipas një modeli të integruar”	Qev. Hollandeze/UNDP	32,524	2010
Mbështetje për pëshkim			
Projekti për portin e ri të peshkimit në Durrës	Banka Islamike	182,000	2010
Programi i pyjeve			
Projekti i Zhvillimit të burimeve natyrore	IDA/GEF/SIDA	194,000	2011
Total		594,000	